



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë , më \_\_\_\_\_.2025

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I SHESHIT TË FSHATIT GJILEKË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për zhvillim urban **45211360-0**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **83,333,333** (tetëdhjetë e tre milionë e treqinde tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë) lekë **pa TVSH** , vënë në dispozicion nga **buxheti i Bashkisë Himarë**.

**Perilogaritja e fondit limit** dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter

kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** dhe **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, neni 26 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, pika 6 “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “*Per procedurat tatimore*” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “*Per QKB*” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “*Per QKR*” i ndryshuar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përllëgëritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Aktin e Kolaudit të objektit
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- v. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

▪ **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **NP.1** –Punime Germimi ne toke   **Klasifikimi A**
- **NP.3** – Rikonstruksion e mirembajtje godinash   **Klasifikimi A**
- **N.P. 4** -Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linjatramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pistaeroportuale   **Klasifikimi A**

- **NP.7** – Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje  
**Klasifikimi A**
- **N.P. 11:** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike **Klasifikimi A**
- **N.P. 12** Punime të inxhinierisë mjedisore **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
  - **NS- 2** – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre  
**Klasifikimi A**
  - **NS- 4** – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to **Klasifikimi A**
  - **NS- 6** – Sinjalistika rrugore jodriçuese **Klasifikimi A**
  - **NS- 8** – Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri **Klasifikimi A**
  - **NS- 14** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV  
**Klasifikimi A**
  - **NS- 18** –Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

*\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

.

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkua | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës                                                                          | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse                                                                                                                                                                                                                                                   | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| NP-1               | Punime gërmimi në tokë.                                                                                                         | Punime gërmim dheu, Punime prishje, Punime gërmim shkëmbi i fortësive të ndryshme me ekskavator.                                                                                                                                                                                                                                                 | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NP-3               | Rikonstruksion e mirembajtje godinash                                                                                           | Punime për rikonstruksionin e objektit, suvatime, hidroizolimi, llustra, dyer, dritare, çati, punime gipsi.                                                                                                                                                                                                                                      | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| N.P - 4            | Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale                    | Shtresa rrugore dhe punime të tipologjise së rrugëve dytësore dhe/ose linja të punimeve, punime shtresash, asfalto beton.                                                                                                                                                                                                                        | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| N.P - 7            | Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje                                                                     | Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vende, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit. | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| N.P - 11           | Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike | Punime për gabinen elektrike që do të bëhet e re.TM.                                                                                                                                                                                                                                                                                             | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NP-12              | Punime të inxhinierisë mjedisore                                                                                                | Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme. realizimi i lulishtëve duke patur në konsideratë mjedin dhe tipologjinë e objektit.      | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NS-2               | Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre                                                                  | Punime në objekt për sistemin e furnizimit me ujë dhe instalimet e paisjeve hidrosanitare, furnizim të mbrojtjes nga zjarri, shkarkimin e ujrave të zeza.                                                                                                                                                                                        | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NS-4               | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to                                                                             | Punime rifiniture në objektin për rikonstruksion, pllaka, ulluqe, murature, patinime, leryje me boje, punime termoizolimi.                                                                                                                                                                                                                       | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NS-6               | Sinjalistika rrugore jodriçuese                                                                                                 | Punime sinjalistike horizontale, vendosje kurriresh artificiale në rrugë.                                                                                                                                                                                                                                                                        | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |
| NS-8               | Ndërtime parafabrikat me beton të armuar,                                                                                       | Punime betoni, themele, konstruksione                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | A                                                         | 0-21 milion                                                                                    |

|       |                                                            |                                                                                            |   |             |
|-------|------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|---|-------------|
|       | struktura metalike dhe druri                               | metalike,pilota.                                                                           |   |             |
| NS-14 | Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni | Punime te brenshme elektrike,punime instalimi per ndriçim.kuadro elektrik,punime tokezimi. | A | 0-21 milion |
| NS-18 | Punime topogjeodezike                                      | Rilevim topografik,piketim per rrugen,sheshin.                                             | A | 0-21 milion |

### 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (*Sistem i Menaxhimit te Cilesise*)
- **ISO 14001:2015** (*Sistem i Menaxhimit Mjedisor*)
- **ISO 45001:2018** (*Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune*)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë

punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësi ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mirë të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 65 (*gjashtedhjetë e pesë*) **punonjës**, me kohë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :** Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **65 (gjashtedhjetë e pesë)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për 3 (tre) muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë

janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 65 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në kriteret elementarë të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

### **2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libereze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni1(një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni1(një) **Inxhinier Mjedi**
- Minimuni1(një) **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni 1 (një) **Arkitekt**
- Minimuni 1(një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet,

*përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :**Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

**1.Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, duke siguruar zbatimin e saktë të projektit dhe duke pasur parasysh Specifikimet Teknike dhe projektin e miratuar.

**2.Arkitekt,** ben ndjekjen e zbatimit të punimeve duke pasur parasysh natyrën e objektit, dhe vlerësuar planin arkitektonik,perzgjedhur materialet dekorative gjate nderhyrjes. Gjithashtu duke pasur parasysh rikonstruksionin e objektit dhe duke garantuar efektshmerine e investimit,duke e kthyer ne nje atraksion turistik.

**3.Inxhinier Gjeodet/ Markshejder,** është përgjegjës për dhe do të kryejë azhornimin topografik dhe piketimin e objektit ndërtimor, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built). Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

**4.Inxhinier Hidroteknik,** i domosdoshëm për punimet, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave hidroteknike, etj.Konkretisht kapitulli Nr 10,Nr 21 i preventivit si dhe analizat e bazuara në projekt .

**5.Inxhinier Mjedisi,** I nevojshëm për zbatimin e projektit,përgjegjës per mbarvatjen e te gjitha punimeve dhe sigurimin qe punimet e kryera mos cenojne kushtet dhe parametrat mjedisore te terrenit dhe te kene ndikim sa me te vogel ne mjedis

**6.Inxhinier Elektrik,** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave elektrike, etj Ai do të kryej kontrollle gjate punimeve,testet ne perfundim të kërkuara sipas specifikimeve teknike dhe do të garantojë suksesin e investimit. Konkretisht kapitulli Nr 20, i preventivit si dhe analizat e bazuara në project.

**b) Operatori ekonomik** duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Teknik i Mesëm Ndërtimi jo më pak se **1** (nje) punonjës
- Teknik Topograf jo më pak se **1** (një) punonjës
- Teknik Elektrik jo më pak se **1**(një) punonjës
- Teknik Elektro/mekanik jo më pak se **1**(një) punonjës
- Hekurthyes - jo më pak se **4** (katër) punonjës
- Kaperntier - jo më pak se **3** (gjashtë) punonjës
- Murator – jo më pak se **5** (pesë) punonjës

- Betonues – jo më pak se 4 (pesë) punonjës
- Punonjes dyer/dritare – jo më pak se 1 (nje) punonjës
- Elektriçiste– jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Pllakashtrues jo më pak se 3 (tre) punonjës
- Hidraulik jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Bojaxhi jo më pak se 1 (një) punonjës
- Hidroizolues jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Konstruksiione metalike jo më pak se 1 (një) punonjës
- Punëtorë të thjeshtë– jo më pak se 13 (trembedhjetë) punonjës

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf/elektriçist/elektromekanik diplome të shkollës së mesme profesionale si dhe te jene te paisur me ,Dëshmi te Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga nje trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Te gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit qe ka lëshuar dokumentin per specialistet e kualifikuar me siper.

*Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.*

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Teknik i mesem ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik i mesem topograf**, referuar zerave të preventivit dhe projektit të miratuar, tekniku i mesem gjeodet se bashku me inxhinierin do të bëjë pozicionimin korrekt të objektit duke siguruar që objekti të ketë funksionalitet të plotë.
- **Teknik i mesem elektrik**, referuar zerave të preventivit dhe projektit të miratuar, të tilla si punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur të kuadri kryesor i godinës, duke siguruar që objekti të ketë siguri dhe funksionalitet të plotë. Gjithashtu se bashku me inxhinierin janë përgjegjës për instalimin e gabines elektrike, testet dhe mbarevajtjen e punimeve elektrike.
- **Teknik i mesem elektromekanik**, referuar zerave të preventivit dhe projektit të miratuar, tekniku i mesem elektromekanik bën vlerësimin e materialeve dhe pajisjeve është përgjegjës për instalimin e pajisjeve të pompës MKZ, pompës së furnizimit me ujë, pompës së drenazhit, traute të parkimit, se bashku me inxhinierin elektrik bëjnë lidhjet e sakta elektrike të pajisjeve duke siguruar që objekti të ketë funksionalitet të plotë.
- **Hekurkthyes**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve të hekurit të betonit referuar zërave të analizave dhe preventivit, konkretisht kapitullit Nr 25.
- **Karpiertier**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të armatës sipas analizave dhe preventivit, konkretisht kapitullit Nr 18.
- **Murator**, i specializuar ka njohuritë dhe përvojën për të siguruar që muret dhe strukturat të jenë ndërtuar sipas standardeve më të larta, referuar preventivit të punimeve, konkretisht kapitullit Nr 5, Nr 12.
- **Betonues**, është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin, konkretisht kapitullit Nr 14, Nr 24.
- **Punonjes për dyer/dritare**, bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar analizave dhe preventivit, konkretisht kapitullit Nr 18.
- **Elektrici**, të specializuar dhe kanë njohuritë dhe përvojën për të siguruar që punimet dhe instalimet elektrike të jenë sipas standardeve më të larta, referuar preventivit të punimeve, konkretisht kapitullit Nr 20, dhe punimeve elektrike për gabinin e re.
- **Pllakashtrues**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit janë të nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të shtresave të pllakes sipas analizave dhe preventivit, konkretisht punime shtresa pllaka gres dhe punime shtresa pllaka guri dekorative.
- **Hidraulike**, të specializuar dhe kanë njohuritë dhe përvojën për të siguruar që punimet dhe instalimet hidraulike të jenë sipas standardeve më të larta, referuar preventivit të punimeve, konkretisht kapitullit Nr 10, Nr 21.

- **Bojaxhi**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit janë të nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve patinimit dhe lysterjeve sipas analizave dhe preventivit, konkretisht kapitullit Nr 19.
- **Hidroizolues**, projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të hidroizimit. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me hidroizimin për ambientet në kontakte me ujin, referuar preventivit të punimeve, konkretisht kapitullit Nr 15, rendor 44 dhe 49.
- **Punonjes konstruksione metalike**, është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike në objekt, bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar analizave dhe preventivit, konkretisht kapitullit Nr 9.
- **Punëtorë të thjeshtë**, të cilët do të realizojnë të gjitha punët e pa specializuara në kantier, në përputhje me normat dhe standartet teknike

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat

minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- b) 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit ... 1.

Punëdhësi ngarkon një ose disa punëmarres, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje /institucion ..., dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtareve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmange apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Bazuar dhe në V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

- d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (*nga Administratori i shoqërisë*) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi :**Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt

është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Eskavatoriste – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Automakinist – jo më pak se 1 (nje) punonjës
- Shofer– jo më pak se 2 (dy) punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilin të deklaruar për çdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjesit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

### 2.3.7 (Makineri, Pajisje)

**a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

| Nr | Lloji i Makinerive                                                | Statusi                                   | Sasia  |
|----|-------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|--------|
| 1  | Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 20 ton | në pronësi ose me qira                    | Copë 2 |
| 2  | Kamion me vinc                                                    | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 3  | Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 6-7.5 ton                | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 4  | Kamioncine vetshkarkues me kapacitet mbajtes deri ne 2 ton        | në pronësi ose me qira                    | Copë 2 |
| 5  | Autopompe Betoni                                                  | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 6  | Autobetonire                                                      | në pronësi ose me qira                    | Copë 2 |
| 7  | Makineri per vijezim asfalti                                      | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 8  | Fadrome ( mjet teknologjik me goma)                               | në pronësi ose me qira                    | Copë 2 |
| 9  | Eskavator me goma me çekiç (mjet teknologjik me goma)             | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 10 | Minieskavator                                                     | në pronësi ose me qira                    | Copë 2 |
| 11 | Rrul vibrues                                                      | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 12 | Autobot uji                                                       | në pronësi ose me qira                    | Copë 1 |
| 13 | Nyje prodhimi betoni, leje mjedisore Tipi B III.1.B               | në pronësi ose me qira/kontrate furnizimi | Cope 1 |

|    |                                                            |                        |         |
|----|------------------------------------------------------------|------------------------|---------|
| 14 | Automjet per transport mjetesht kapaciteti mbajtes 4-5 ton | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 15 | Tranxhe per kthim hekuri                                   | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 16 | Pajisje gjeodezike tip GPS                                 | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 17 | Kontenier ndërtim I levizshem (zyrë)                       | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 18 | Dumper (mjetteknologjik me goma)                           | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 19 | Sonde per pilota (per dimencion Ø 800 mm)                  | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 20 | Betonier kantjeri                                          | në pronësi ose me qira | Copë 2  |
| 21 | Karroca dore                                               | në pronësi ose me qira | Copë 10 |
| 22 | Kompresor ajri                                             | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 23 | Prerese pllakash                                           | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 24 | Gjenerator                                                 | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 25 | Vibrator betoni                                            | në pronësi ose me qira | Copë 2  |
| 26 | Depozite uji jo me pak se 1000 lit                         | në pronësi ose me qira | Copë 2  |
| 27 | IDROSEMINATRICE TM35                                       | në pronësi ose me qira | Copë 1  |
| 28 | Freze per skarifikim asfalti                               | në pronësi ose me qira | Copë 1  |

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 65 copë*
- Jelek per kantier fosforoshent - *jo më pak se 65 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 13 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

- 4- **Për pajisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimit*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (të paktën 1).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

**Shënim:** Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në disa fronte me duke patur parasysh pozicionimin e objektit, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Dumper referuar analizave 3.47/1c,3.396/1,2.583
- Kamionçine vetshkarkues me kapacitet mbajtes deri ne 2 ton, e nevojshme per transporte te ndryshme jashte kantierit
- Kamjon veteshkarkues me kapacitet jo me pak se 20 ton,te nevojshem per transporte, kapitullit Nr 11, analize 2.37/5b.Kapitulli Nr 5,analize 3.352.
- Kamjon veteshkarkues me kapacitet 6-7.5 ton,te nevojshem per transporte, kapitullit Nr 16, analize 2.258, 2.261.
- Kamjon me vinç,te nevojshem per ngritjen e materialeve, kapitullit Nr 15, analize 2.219,ngritje hekur pilotash kapitulli Nr 25.
- Autopompe betoni, e nevojshme per betonime te strukturave te armuara sipas kapitullit Nr 24
- Autobetoniere,e nevojshme per betonime te strukturave te armuara sipas kapitullit Nr 24
- Nyje prodhimi betoni leje mjedisore Tipi B III.1.B (leja e mjedisit I sherben mbrojtjes se ambientit) ,e nevojshme per prodhim betoni per strukturat e armuara sipas kapitullit Nr 24
- Makineri per vijezim asfalti, e nevojshme per sinjalistiken horizontale sipas kapitullit Nr 26
- Fadrome ( mjet teknologjik me goma) e nevojshme per pune dhe sisteme ne kantier sipas analize 3.164/1a,3.164/1b,3.352,3.640,3.643/c.
- Eskavator me goma me çekiq (mjet teknologjik me goma) e nevojshme per punime sipas kapitullit Nr 2,Nr 22.
- Minieskavator, te nevojshem per punime ne kantier per hapje kanalesh ujesjellesh,hapje kanalesh per tubo drenazhi,sisteme skarpatash,sisteme sheshi, dhe sisteme ne hapësira te ngushta.
- Rrul vibruës te nevojshem per punime sipas kapitullit Nr 3.
- Autobot uji e nevojshme per furnizimin e objektit me uje per pregatitjen e llaçit,beton qe pregatitet ne kantier.
- Automjet per transport mjetesh kapaciteti mbajtes 4-5 ton,per levizjen e minieskavatoreve si brenda kantierit ashtu dhe jashte tij.
- Tranxhe per kthim hekuri e nevojshme per pregatitjen e hekurit sipas kapitullit Nr 25.
- Pajisje gjeodezike tip GPS e nevojshme ne kantier per te hene kuato,per te piketuar objektin,per te dhene kuota te endryshme.
- Kontenier ndërtim I levizshem (zyrë),e nevojshme per stafin teknik,mbajtje dokumentacioni.
- Sonde per pilota (per dimencion Ø 800 mm) e nevojshme per punimet sipas kapitullit Nr 23.
- Betoniere Kantieri,e nevojshme per pregatitje llaçi per suvatim dhe per mure betone pusetash.
- Karroca dore te nevojshme per levizje materialesh gjte punime brenda kantierit.
- Kompresor ajri i nevojshme per pastrimin e sheshit nga pluhurat para shtrimit te pllakes,sipas analizes jashte liste AN,nr rendor 107.

-Prerese pllakash e nevojshme per prerjet e pllakes,sipas analizes jashte liste AN,nr rendor 107, 2.267b

-Gjenerator per funksionimin e paisjeve qe kane nevojë per rryme elektrike ne kantier.

-Vibrator betoni per ngjeshjen e betonit ne strukturat e betonit.

- Depozite uji jo me pak se 1000 lit per depozitim uji ne kantier.

- IDROSEMINATRICE TM35 e nevojshme ne kantier per punime sipas analizes 3.643, 3.960.

- Freze per skarifikim asfalti e nevojshme ne kantier per punime sipas analizes 3.969.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet te kete kontratë me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017

**Argumentimi** Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi apo me qera i ketyre fabrikave eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrurnin tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.14 Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për "Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve" më Kod III.2.B

**Argumentimi** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: *"leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji"*.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikohet se: *"Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri"*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta": *"Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si*

*grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, i Preventivin si dhe analizen e cmimeve për zërat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE, grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.16 Deklarate e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt si më mëposhtë:

- Pompë MKZ EN 12845
- Trau parkimit

2.3.17 Për pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.16, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje. Në rast paraqitje autorizim distributori i autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet sipas pikës 2.3.16. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje.

*Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.*

2.3.18 Operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë, për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi ne kete mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nëpërmjet dorezimit të këtij dokumentacioni që ne fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon

kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**